



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 03.09.2021, Nr. 09-111/01-43386



Në bazë të nenit 64 pika 1 Ligjit nr. 06/L-114 për Zyratet Publike të Republikës së Kosovës, në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, procesverbalit me referencë 10/01, nr.prot. 184/08 të datës 02.09.2021 të Inspektorit të Arsimit SIA (MASHTI) – Prishtinë, Drejtorati për Arsim në Drenas, bënë këtë:

RISHPALLJE TË KONKURSIT

1. SHFMU” Migjeni” në Baicë
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, për vitin shkollor 2021/2022, me mundësi vazhdimi.
2. SHFMU” Mehmet Gradica” në Gradicë
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, me kohë të pacaktuar.
3. SHFMU” Bajram Curri” në Nekoc
 - Dy mësimdhënës për arsim fillor, deri sa të këthehen punëtorët prej pushimit të lehonisë.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.05 / 2021, MASHTI.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma ose çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar në Komunë ose të Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës vetëm në arsim (nëse keni).
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur me çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
7. Kopje të çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim, më gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,
Më:03.09.2021

Drejtor për Arsim
Muhamet Gjoka